

L I G J
Nr.7970, datë 20.7.1995

PËR RREGULLIMIN E SEKTORIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.04.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozim të Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I :

PJESA E PARË
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti i ligjit

Me këtë ligj ngrihet një ent rregullues i pavarur që do të quhet Enti i Rregullimit të Sektorit të Energjisë Elektrike (ERE). Ky ligj përcakton funksionet, detyrat dhe të drejtat e Entit të Rregullimit të Sektorit të Energjisë Elektrike, procedurat dhe standardet në bazë të të cilave ai do të veprojë, si dhe do të parashikojë kushtet e licencave dhe rregullimin e veprimtarive të personave që do të ushtrojnë funksione në sektorin e energjisë elektrike.

Neni 2
Përcaktime

Në këtë ligj shprehjet e mëposhtme do të kenë kuptimet:

1."Enti i Rregullimit (ERE)" do të kuptohet si institucioni i Rregullimit të Sektorit të Energjisë Elektrike, që ngrihet sipas nenit 3 të këtij ligji.

2."Konsumatori i energjisë elektrike me shumicë" do të kuptohet ai konsumator që blen ose merr energji elektrike me fuqi më të madhe se një megavat ose me karakteristika të tjera të tilla që do t'i përcaktojë Enti me rregullore.

3."Konsumator" do të kuptohet një person ose vazhduesi i interesave të tij që blen ose merr energji elektrike për konsum dhe jo për ta dhënë ose për ta shitur te të tjerët, duke përfshirë edhe personin që zotëron ose ka vendin ku jepet energjia elektrike.

4."Shpërndarje" do të kuptohet zotërimi, shfrytëzimi, administrimi dhe kontrolli i mjeteve të shpërndarjes për transportin, dhënien ose shitjen energjisë elektrike konsumatorëve dhe sigurimi i furnizimit të konsumatorëve. Nuk quhet shpërndarje: zotërimi, shfrytëzimi, administrimi dhe kontrolli i mjeteve të shpërndarjes të vendosura në pronën private ose të qiraxhinjtë të tij dhe që përdoren vetëm për të transportuar ose dhënë energji elektrike të personi që i zotëron, shfrytëzon, administron dhe kontrollon këto mjete.

5."Mjetet e shpërndarjes" do të kuptohen mjetet elektrike që punojnë me tensionet e shpërndarjes dhe që përdoren për transportin ose dhënien e energjisë elektrike.

6."Tensioni i shpërndarjes" do të kuptohet tension më i vogël se i transmetimit.

7."Shërbimet e energjisë elektrike" do të kuptohen prodhimi, transmetimi dhe shpërndarja e energjisë elektrike.

8."Qeveria" do të kuptohet Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë.

9."Ministria" do të kuptohet Ministria e Burimeve Minerare dhe Energjetike ose vazhduesi i saj.

10."Prodhimi" do të kuptohet zotërimi, shfrytëzimi, administrimi dhe kontrolli i mjeteve të prodhimit të energjisë elektrike ose shitja e saj që u bëhet shoqërive të shpërndarjes ose konsumatorëve, por jo konsumi vetjak nga personi që zotëron, shfrytëzon, administron dhe kontrollon këto mjete.

11."Shoqëri prodhimi" do të kuptohet një person që merret me prodhimin e energjisë elektrike.

12."Mjetet e prodhimit" do të kuptohen mjetet që përdoren për prodhimin e energjisë elektrike.

13 "Shërbimi i lidhjes ndërsistimore" do të kuptohet lidhja e sigurt dhe e qëndrueshme e mjeteve elektrike të një personi me mjetet elektrike të një personi tjetër duke patur parasysh: (1) çdo mjet të nevojshem që bën të mundur lidhjen, (2) veprimin e koordinuar të sistemeve të lidhura dhe (3) rëndësinë ekonomike të një lidhjeje të tillë me këto sisteme të lidhura.

14."Licencë" do të kuptohet një leje që i jepet një personi sipas pjesës III të këtij ligji.

15."Mbajtësi i licencës" do të kuptohet një person që mban licencë sipas pjesës III të këtij ligji.

16."Tensioni minimal i transmetimit" do të kuptohet një tension i tillë, që ERE me anë të rregullores e përcakton si tension minimal me të cilin do të operojnë përgjithësisht mjetet elektrike në Shqipëri kur përdoren për të dhënë energji elektrike me shumicë. Në rast se Enti jep ose ndryshon një licencë sipas pjesës III të këtij ligji, tensioni minimal i transmetimit brenda territorit të shërbimit të lejuar me licencë, mund të jetë më i madh ose më i vogël nga ai që përcaktohet në rregullore.

17."Anëtar" do të kuptohet një anëtar rregullisht i caktuar si edhe kryetari i ERE-së sipas këtij ligji.

18."Shoqëria e Rrjetit të Transmetimit" do të kuptohet personi që ka në atë moment licencën e transmetimit të energjisë elektrike sipas pjesës III të këtij ligji.

19."Person" do të kuptohet çdo person fizik a juridik.

20."Transmetim" do të kuptohet zotërimi, shfrytëzimi, administrimi dhe kontrolli i mjeteve të transmetimit për qëllimet përkatëse.

21."Shoqëri transmetimi" do të kuptohet një person që merret me transmetimin e energjisë elektrike.

22."Mjetet e transmetimit" do të kuptohen mjetet elektrike duke përfshirë qarqet elektrike, transformatorët dhe nënstacionet, që punojnë me ose sipër tensionit minimal të transmetimit, me kusht që termi të mos përfshijë: (a) qarqet elektrike që formojnë lidhjen e drejtpërdrejtë midis mjeteve të prodhimit dhe rrjetit të transmetimit deri në kufirin e ndarjes së tyre, që zotërohen nga një shoqëri prodhimi dhe që lidhen me mjetet e prodhimit të shoqërisë;(b) mjetet e specifikuara, që punojnë me ose mbi tensionin minimal të transmetimit në rast se Enti i Rregullimit , duke lejuar një licencë që jepet sipas pjesës III të këtij ligji, përcakton se këto mjete do të jenë pronë dhe do të shfrytëzohen nga mbajtësi i licencës për shpërndarje.

PJESA E DYTË NGRITJA E ERE-SË

Neni 3

Ngritja dhe përbërja e ERE-së

(1) ERE është person juridik me të gjitha të drejtat dhe detyrat sipas legjislacionit në fuqi.

(2) Këshilli Drejtues i ERE-së përbëhet prej pesë anëtarësh që do të caktohen nga Qeveria nëpërmjet personave të zgjedhur nga Ekipi Përzgjedhës në përputhje me dispozitat e paragrafit (3).

(3) Ekipi Përzgjedhës duhet:

(a) të mblidhet sa herë të jetë e nevojshme dhe gjithnjë jo më vonë se gjashtë muaj para përfundimit të afatit të mandatit të një anëtari të ERE-së;

(b) të përbëhet nga dy anëtarë që caktohen nga Parlamenti dhe një anëtar që caktohet nga Qeveria. Per çdo vend vakant në ERE, Ekipi Përzgjedhës duhet të zgjedhë një kandidat të përshtatshëm që të ketë aftësi dhe përvojë të tillë si ato që kërkohen në paragrafin (5). Anëtarët e Ekipit Përzgjedhës duhet të veprojnë menjëherë dhe brenda tri muajsh që nga ngritja e Ekipit Përzgjedhës në zgjedhjen e kandidatit që, me vendim të shumicës, ata e mendojnë se është më i përshtatshmi për të kryer funksionet, të drejtat dhe detyrat e një anëtari të ERE-së sipas këtij ligji. Në bërjen e seleksionimeve, Ekipi Përzgjedhës duhet të ketë parasysh aftësitë, kualifikimin dhe përvojën e çdo anëtari të ERE-së që është caktuar, me qëllim që të arrihet ekuilibri i aftësive dhe kualifikimeve që kërkohen sipas paragrafit (5).

(4) Kur mbetet bosh vendi i kryetarit të ERE-së, Ekipi Përzgjedhës duhet menjëherë të përzgjedhë kandidatin prej anëtarëve të ERE-së, që ai rekomandon të caktohet kryetar. Derisa të bëhet një rekomandim i tillë, anëtari më i vjetër i ERE-së do të veprojë si kryetar, duke patur parasysh se vjetërsia njihet që nga data kur ai anëtar është caktuar në Këshillin Drejtues të ERE-së.

(5) Anëtarët e ERE-së duhet të jenë persona kompetentë, me reputacion dhe aftësi të njohura, dhe:

(a) kryetari duhet të jetë një person i shquar për aftësi në punë, që ka të paktën 5 vjet punë në administratën shtetërore, në drejtësi, në sektorin e energjisë elektrike ose në biznese të tjera të njohura tregtare;

(b) dy nga anëtarët duhet të kenë përgatitje profesionale inxhinierike me mbi pesë vjet përvojë të dalluar inxhinierike në prodhimin, transmetimin ose shpërndarjen e energjisë elektrike;

(c) dy anëtarë duhet të kenë kualifikim profesional ose mbi pesë vjet përvojë të dalluar në ekonomi, tregti, kontabilitet, financë, drejtësi, administrim juridik dhe administrim publik; (d) funksioni i anëtarit të Parlamentit, të Qeverisë, ose i ndonjë autoriteti të pushtetit lokal është i papajtueshëm me funksionin e anëtarit të Këshillit Drejtues të Entit të Rregullimit.

(6) Kryetari i parë i caktuar nga qeveria do të vazhdojë në këtë post për një periudhë prej pesë vjetësh që nga krijimi i ERE-së. Anëtarët e parë që caktohen sipas këtij ligji do të vazhdojnë në këtë post për periudha prej katër, tri, dy dhe një vit, përkatësisht, duke filluar nga krijimi i ERE-së.

(7) Vazhduesit e kryetarit dhe të anëtarëve të parë do të caktohen për një periudhë prej katër vjetësh që nga data e përfundimit të afatit për të cilin ishte caktuar paraardhësi i tij, me përjashtim të rastit kur një person caktohet të zërë një vend bosh, që hapet përpara se të mbarojë afati për të cilin ishte caktuar paraardhësi i tij; në këtë rast, ai person duhet të caktohet vetëm për periudhën e mbetur.

(8) Asnjë anëtar nuk duhet të caktohet të shërbejë në Këshillin Drejtues të ERE-së për më tepër se dy afate të plota.

(9) Përpara caktimit në këtë detyrë, çdo anëtar duhet të heqë dorë nga çdo punë, post ose funksion konsultimi dhe duhet të shesë ose zhvishet nga çdo interes, që mund të ketë në favor të tij (qoftë në emër të tij, qoftë ndryshe) në ndonjë shoqëri, që kryen ndonjërin prej bizneseve të mëposhtme:

(a) prodhimin, transmetimin, shpërndarjen ose furnizimin me energji elektrike;

(b) prodhimin, shitjen ose furnizimin e ndonjë lënde djegëse për prodhimin e energjisë elektrike;

(c) prodhimin, shitjen ose marrjen me qira të makinerive, fabrikave, pajisjeve ose aparateve për prodhimin, transmetimin, shpërndarjen ose përdorimin e energjisë elektrike; ose

(d) çdo entitet që siguron shërbim profesional ose këshillimor për ndonjërin prej bizneseve të përmendura në gërmat (a), (b) ose (c) të mësipërme.

Nuk do të quhet e ligjshme për çdo anëtar të Këshillit Drejtues të ERE-së, që jo vetëm për sa kohë që mban këtë post, por edhe për një periudhë prej dy vjetësh pas saj, të mbajë, të përfitojë ose të blejë për interes të tij (qoftë në emër të tij, qoftë ndryshe) ndonjë post, ose punësim, ose interes në një shoqëri të tillë. Kur ai, me ndonjë testament ose dhuratë përfiton ndonjë interes, ai duhet ta shesë atë brenda tre muajsh pasi të jetë bërë përfitues i saj dhe duhet të mos ketë më ndonjë interes, të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, në një gjë të tillë. Asgjë që përmban ky paragraf nuk do të pengojë kryetarin ose një anëtar të Këshillit Drejtues të ERE-së që të përfitojë ose të mbajë një aksion ose interes në ndonjë shoqëri ose firmë që kryen një biznes të llojit që nuk përmendet në këtë paragraf.

(10) Çdo anëtar duhet që menjëherë pas caktimit, të heqë dorë nga çdo post tjetër që ka në Parlament ose në Qeveri dhe nga çdo pozitë tjetër, nderi ose ndryshe, që mund t'i tërheqë vëmendjen nga detyra për t'i shërbyer Entit me efektivitet.

Neni 4

Heqja e anëtarëve të Këshillit Drejtues të ERE-së

(1) Qeveria mund të heqë nga posti çdo anëtar të Këshillit Drejtues të ERE-së, që:

(a) rezulton ose bëhet mendërisht i sëmurë;

(b) gjykohet se gjatë veprimtarisë së tij rezulton i paaftë për kryerjen e detyrave të ngarkuara;

(c) vepron në kundërshtim me dispozitat e paragrafit (9) të nenit 3;

(d) bëhet ose kërkon të bëhet anëtar i Kuvendit Popullor, nëpunës në administratën shtetërore

ose i ndonjë autoriteti lokal;

(e) ka refuzuar pa arsye të mjaftueshme të veprojë ose është bërë i paaftë të veprojë për një periudhë prej të paktën 6 muajsh; ose

(f) është dënuar penalisht.

(2) Kur Qeveria vëren se ndonjë anëtar i Këshillit Drejtues të ERE-së duhet të hiqet në bazë të paragrafit (1) të këtij neni, ajo duhet ta njoftojë anëtarin në fjalë me shkrim dhe t'i japë atij mundësi që ta paraqesë shpjegimin e tij para Qeverisë.

(3) Kur, pasi një anëtar i Këshillit Drejtues të ERE-së i është dhënë mundësia të paraqesë shpjegimin e tij dhe Qeveria konstaton se ky është rast i parë kundër tij, ajo duhet të caktojë një person kompetent të kualifikuar, që të ndjekë çështjen dhe të paraqesë një raport me konstatimet. Pasi të marrë raportin, Qeveria duhet t'i marrë në shqyrtim rekomandimet dhe duhet t'i bëjë të njohura vendimet e saj.

(4) Kur merret një vendim për largim, në vend të anëtarit të hequr caktohet një anëtar tjetër sipas nenit 3 për të mbushur vendin vakant.

(5) Anëtar i që është larguar ligjërisht sipas këtij neni nuk ka të drejtë të rizgjidhet si anëtar ose në ndonjë funksion tjetër në Këshillin Drejtues të ERE-së.

(6) Në rast se anëtar i, që është caktuar Kryetar i Këshillit Drejtues të ERE-së hiqet me të drejtë nga posti i anëtarit, sipas këtij neni ai pushon së qenuri edhe Kryetar i Këshillit Drejtues të ERE-së.

Neni 5

Veprimtaria e ERE-së

(1) Qendra e ERE-së do të jetë në Tiranë, por ERE ka të drejtë t'i mbajë punimet dhe konsultimet e tij edhe në pjesë të tjera të Republikës së Shqipërisë.

(2) ERE do të ketë të drejta ekskluzive të nxjerrë rregullat dhe procedurat e veta të punës për të siguruar funksionimin efektiv dhe për të kryer detyrat e tij sipas këtij ligji. Të gjitha këto rregulla dhe procedura duhet të botohen ose të vihen në dispozicion të publikut.

(3) Këshilli Drejtues i ERE-së duhet t'i marrë vendimet me shumicë vote. Secili anëtar përfshirë kryetarin ka një votë. Asnjë vend bosh në Këshillin Drejtues të ERE-së nuk do ta cenojë të drejtën e anëtarëve që mbeten për të ushtruar të gjitha të drejtat e Këshillit Drejtues të ERE-së.

(4) Çdo anëtar për zgjidhjen urgjente të problemeve ka të drejtë të kërkojë mbledhjen e Këshillit Drejtues të ERE-së në çdo kohë, me kusht, që ai të ketë njoftuar që më parë për kohën, vendin dhe çështjet që kërkojnë vendimin e Këshillit Drejtues të ERE-së.

(5) Numri i nevojshëm i anëtarëve që kërkohet për të patur kuorum në një mbledhje të Këshillit Drejtues të ERE-së duhet të jetë tre për kryerjen e punëve të zakonshme dhe të gjithë anëtarët e tij për rishikimin e një vendimi të mëparshëm të Këshillit Drejtues të ERE-së.

(6) Këshilli Drejtues i ERE-së i ka të gjitha fuqitë që nevojiten për të përfutur informatat e nevojshme me qëllim që ai të mund të kryejë funksionet, të drejtat dhe detyrat e tij sipas këtij ligji, duke përfshirë të drejtën për të kërkuar, që çdo i licensuar të japë një listë të pasurive që zotëron ose që ia ka kaluar një pale të tretë, si dhe llogari të tjera në lidhje me marrëveshjet e tij të punës.

(7) Këshilli Drejtues i ERE-së do të ngarkojë kryetarin, anëtarët e tij ose stafin që ka dhe t'i vërë ata në dispozicion të palëve ose grupeve, interesat e të cilëve preken ose që ka të ngjarë të preken nga vendimet e tij në përputhje me rregullat dhe procedurat që përmenden në paragrafin (2).

(8) Këshilli Drejtues i ERE-së do t'i japë vendimet e tij me shkrim dhe do t'i shpjegojë arsyet e tij për ato vendime.

(9) Këshilli Drejtues i ERE-së gjatë kryerjes së detyrave dhe funksioneve të tij sipas këtij ligji, ka të drejtë:

(a) të marrë deklarata ose vërtetime të tjera të noterizuara;

(b) të kontrollojë dhe të verifikojë në vend dokumentacionin, si dhe evidencat dhe materiale të tjera;

(c) të nxjerrë dokumente ose objekte të tjera materiale që të përdoren si prova.

Neni 6

Roli i Kryetarit të Këshillit Drejtues i ERE-së

- (1) Kryetari vepron si zyrtari kryesor ekzekutiv i ERE-së.
- (2) Njëri nga anëtarët duhet të caktohet si nënkryetar dhe në mungesë të kryetarit do të përmbushë dhe ushtrorë detyrat e të drejtat e tij. Posti i nënkryetarit duhet të kryhet nga të gjithë anëtarët me rotacion.

Neni 7

Shpërblimi dhe kushtet e shërbimit

- (1) Pagat e kryetarit dhe anëtarëve të Këshillit Drejtues të ERE-së caktohen nga Qeveria. Paga nuk mund të ndryshohet nga Këshilli Drejtues e ERE-së, Kryetari ose anëtarët e tij.
- (2) Gjatë afatit të detyrës së kryetarit ose të anëtarëve, as kryetari as anëtarët, as bashkëshortët ose fëmijët e tyre me të cilët bashkëjetojnë nuk duhet të punësohen, të mbajnë ndonjë lidhje zyrtare, këshillimore, të zotërojnë pasuri ose aksione në sektorët e energjisë elektrike, ose të kenë ndonjë interes material me ndonjë person, që pajiset me licencë sipas këtij ligji ose me ndonjë veprimtari që lidhet me të.
- (3) Për dy vjet pas përfundimit të afatit të tij, kryetari ose anëtarët nuk duhet të hyjnë në ndonjë punësim, ose në ndonjë lidhje këshillimore me ndonjë person me licencë të marrë sipas këtij ligji ose me ndonjë person tjetër që lidhet me veprimtari në sektorët e energjisë elektrike në Republikën e Shqipërisë.

Neni 8

Stafi dhe këshilltarët e Këshilli Drejtues të ERE-së

- (1) Në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi, Këshilli Drejtues i ERE-së ka të drejta të plota për të zgjedhur, caktuar, ngritur në detyrë, duke përfshirë edhe të drejtën e heqjes dhe ricaktimit në detyrë, për të përcaktuar detyrat dhe pagat e punonjësve, që përbëjnë stafin profesionist për kryerjen e funksioneve të ERE-së.
- (2) ERE përcakton rregullat e punësimit të stafit profesionist të tij në përputhje me legjislacionin në fuqi.
- (3) ERE ka autoritet ekskluziv për të përcaktuar organizimin e stafit profesionist të tij.
- (4) Përveç punonjësve të stafit profesionist, ERE, sipas nevojës, herë pas herë, mund të punësojë specialistë ose këshilltarë që i nevojiten për kryerjen e funksioneve të tij.

Neni 9

Delegimet e Këshillit Drejtues të ERE-së

- (1) Këshilli Drejtues i ERE-së mund t'i delegojë kryetarit, një anëtarit ose anëtarëve, një zyrtari ose zyrtarëve të tij ndonjëherë prej detyrave, të drejtave ose funksioneve që ai ka sipas këtij ligji, duke përjashtuar:
 - (a) të drejtën për të shqyrtuar kërkesa, lëshuar, kushtëzuar, ndryshuar, ose hequr licenca sipas pjesës III të këtij ligji;
 - (b) të drejtën për të miratuar, mosmiratuar ose ndryshuar tarifa sipas pjesës IV të këtij ligji;
 - (c) të drejtën për të miratuar, mosmiratuar ose modifikuar një program investimesh dhe përftim energjie sipas pjesës V të këtij ligji;
 - (d) të drejtën për të hartuar ose anuluar rregulla sipas pjesës VI të këtij ligji;
 - (e) të drejtën për të vendosur për një apel ose ankesë që i bëhet ERE-së sipas këtij ligji.

Neni 10

Financimi i ERE-së

- (1) Veprimtaria administrative e ERE-së duhet të financohet nga:
 - (a) një grant fillestar, që do të jepet nga Qeveria pas caktimit të kryetarit, sipas nenit 3 të këtij

ligji dhe që do të kthehet brenda tre vjetësh që nga ajo kohë me anë të pagesave sipas paragrafit (b) me poshtë;

(b) pagesa për përpunimin e kërkesave të ndryshme sipas këtij ligji dhe pagesa të tjera që duhet të paguajnë personat me licencë që do të përcaktohen nga ERE.

(2) Fondet e ERE-së duhet të administrohen me anë të llogarive të të ardhurave dhe shpenzimeve, raporti vjetor i të cilave miratohet nga Qeveria.

PJESA E TRETË RREGULLIMI I SEKTORIT TE ENERGISË ELEKTRIKE

Neni 11

Të drejta dhe detyra të përgjithshme të Qeverisë

ERE do të udhëhiqet në veprimtarinë e tij nga ky ligj duke patur parasysh strategjinë e politikës energjetike e cila në asnjë rast të mos pengojë ushtrimin e detyrave, funksioneve dhe të drejtave të tij sipas këtij ligji.

Neni 12

Detyra të përgjithshme të ERE-së

(1) Gjatë ushtrimit të funksioneve dhe të drejtave të tyre sipas këtij ligji, anëtarët e Këshillit Drejtues të ERE-së kanë për detyra të veprojnë në mënyrë që:

(a) të rritin efektivitetin, të përmirësojnë anën ekonomike dhe garancinë nga ana e mbajtësve të licencës si edhe përdorimin efektiv dhe të sigurtë të energjisë elektrike;

(b) t'u japë mundësi mbajtësve të licencës të financojnë veprimtaritë që ata janë të autorizuar të kryejnë sipas licencës;

(c) të krijojnë mundësitë që të gjitha kërkesat e arsyeshme për energji elektrike të plotësohen brenda kufijve të mundësive ekonomike dhe teknike;

(d) të sigurohen që personat me licencë veprojnë në përputhje me kushtet e licencave të tyre dhe u nënshtrohen dispozitave të paragrafit (1);

(e) të mbrojnë interesat e konsumatorëve për energji elektrike në lidhje me : çmimet, tarifat dhe kushtet e tjera të shërbimit; si dhe me cilësinë, efektivitetin, vazhdimësinë dhe qëndrueshmërinë e shërbimit;

(f) të inkurajojnë konkurrencën aty ku është e mundur dhe e efektshme në funksionet e energjisë elektrike;

(g) t'u japin mundësi prodhuesve të energjisë elektrike të lidhen me sistemin e transmetimit dhe të shpërndarjes përfshirë dhe me sistemin financiar në bazë jo diskriminuese, në kushte dhe afate që janë të drejta dhe të arsyeshme;

(h) të ketë transparencë në lidhje me veprimtaritë e sektorit të energjisë elektrike dhe me ERE-në dhe

(i) të ruajnë një ekuilibër të drejtë të interesave të konsumatorëve, shtetit, publikut, investitorëve dhe pjesëmarrësve në sektorin e energjisë elektrike.

(2) ERE vepron si arbitër në konfliktet që lindin midis mbajtësve të licencës.

(3) ERE ka të drejtë:

(a) t'u japë licencë shoqërive për prodhimin, transmetimin dhe shpërndarjen e energjisë elektrike;

(b) të miratojë çmimet ose tarifat dhe afatet e kushtet e shërbimit të energjisë elektrike që propozohen nga personat me licencë ose t'i rishikojë ato sipas kushteve; çmimi i shitjes me pakicë për konsumatorin duhet të jetë brenda nivelit tavan të përcaktuar nga Qeveria;

(c) të përcaktojë procedurat dhe standardet për programet e investimeve dhe të shitjeve të pasurive të mbajtësve të licencës të energjisë elektrike;

(d) të rishikojë punët organizative të mbajtësve të licencës së energjisë elektrike, në masën që këto punë prekin ose ka të ngjarë të prekin shfrytëzimin dhe furnizimin e efektshëm në sektorin e energjisë elektrike;

(e) të zhvillojë dhe të bëjë të detyrueshëm standardet e punës për personat me licencë për

prodhimin, transmetimin dhe shpërdarjen e energjisë elektrike;

(f) të inkurajojë standarde dhe kode të njëjta për të gjithë sektorët e energjisë elektrike;

(g) të vendosë një sistem të njëjtë llogarish;

(h) të japë asistencë në lidhje me nevojën për projekte në sektorin publik;

(i) të përgatisë raporte për sektorin e energjisë elektrike për t'ia paraqitur Qeverisë dhe të mbledhë informacionin e duhur për shoqëritë e prodhimit, transmetimit dhe të shpërndarjes së energjisë elektrike;

(j) të përcaktojë pagesat që do të zbatohen nga personat me licencë;

(k) të vërë sanksione të detyrueshme në rastet e shkeljes të këtij ligji, duke përfshirë edhe dënime monetare;

(l) të hartojë rregullat që lidhen me zbatimin e të drejtave dhe funksioneve sipas kërkesave të këtij ligji;

(m) të kryejë çdo detyrë tjetër që rrjedh nga ndonjë nga funksionet e sipërpërmendura.

(4) Me përjashtim të rasteve kur në këtë ligj përcaktohet shprehimisht, të gjitha vendimet e ERE-së duhet të merren pa ndonjë ndërhyrje nga jashtë përfshirë ato qeveritare.

Neni 13

Kushti për të pasur licencë

(1) Askush, përveç atyre që janë të autorizuar të veprojnë me licencë nuk ka të drejtë të merret me:

(a) prodhimin e energjisë elektrike;

(b) transmetimin e energjisë elektrike;

(c) shpërndarjen dhe furnizimin e energjisë elektrike.

(2) Kur lind ndonjë mosmarrëveshje ose konflikt për një person që po merret ose ka ndërmend të merret me kryerjen e ndonjërit prej funksioneve që përshkruhen në paragrafin (1), çështja duhet t'i referohet ERE-se për ta zgjidhur, dhe vendimet e ERE-së duhet të jenë të formës së prerë.

(3) Kushdo që shkel paragrafin (1) do të dënohet me gjobë fikse dhe, në rastin e shkeljeve të përsëritura, me gjoba ditore. Gjobat fikse në lekë, si dhe gjobat ditore në lekë në ditë do të përcaktohen nga ERE. ERE ka të drejtë të urdhërojë çdo person pa licencë ta ndalojë punën dhe t'i stakojë aparaturat.

(4) Asnjë procedurë nuk do të ndërmerret në lidhje me një shkelje sipas këtij neni, me përjashtim të Qeverisë ose ERE-së.

Neni 14

Kualifikimi i përgjithshëm i mbajtësve të licencës

(1) Çdo person fizik a juridik do të konsiderohet si pretendent për të marrë licencë në përputhje me nenin 15, në qoftë se ai person përcaktohet prej ERE-së se përmbush kushtet e mëposhtme:

(a) ka aftësi tekniko-organizative dhe aftësi financiare për plotësimin e funksioneve që janë të nevojshme për të përmbushur kushtet e zbatimit të licencës;

(b) ka aftësi profesionale dhe një përvojë të mjaftueshme në sektorin e energjisë elektrike për të kuptuar dhe ushtruar plotësisht detyrimet për zbatimin e licencës, ka cilësi personale për të drejtuar biznesin e licensuar;

(c) ka banim në Republikën e Shqipërisë me një zyrë të përhershme dhe një përfaqësues të identifikueshëm, i cili do të jetë përgjegjës për komunikimin me ERE-në dhe me institucione të tjera, si dhe për të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me licencën.

(2) ERE do të kërkojë evidencat, të dhënat dhe dokumentacionin përkatës, që nevojiten për verifikimin e kualifikimit të kërkuesit të licencës; ERE do të refuzojë dhënien e një licence në qoftë se kërkuesi nuk plotëson njërin nga këto kushte, me përjashtim kur ai arrin në përfundimin që ndonjë nga mosplotësimet e mësipërme nuk është serioz dhe është i mundur korrigjimi i tij në kohë, megjithatë ai mund ta japë licencën, ose ta japë atë me kushtet që sigurojnë se i licensuari do t'i riparojë kërkesat e paplotësuara brenda një periudhe kohe të arsyeshme.

(3) Kur ERE pranon dy ose më shumë konkurreues për një licencë për të njëjtën zonë, në bazë

të të dhënave të plotësuara zgjedh kandidatin më të kualifikuar për t'i dhënë licencën.

Neni 15

Dhënia e licencave nga ERE

(1) Pasi të ketë marrë një kërkesë në formën që e kërkon ERE dhe pasi të jetë bërë pagesa që ka të drejtë të marrë, ERE jep licencë, që autorizon një person të kualifikuar:

- (a) të prodhojë energji elektrike me mjetet gjeneruese ose centralet e vetë personit ose
- (b) të transmetojë energji elektrike në zonën e përcaktuar të transmetimit të vetë personit ose
- (c) të shpërndajë dhe furnizojë energji elektrike në zonën e caktuar të vetë personit.

(2) Në lidhje me dhënien e një licence të tillë duhen zbatuar dispozitat e mëposhtme:

(a) çdo person që kërkon licencë, sipas këtij neni, duhet të publikojë një njoftim të kërkesës së tij në mënyrën dhe me veçoritë që përshkruhen nga ERE brenda 14 ditëve pasi ta ketë bërë kërkesën, dhe licenca nuk do t'i jepet përpara se të gjitha kundërshtimet që ka marrë ERE, që lidhen me kërkesën për atë licencë, të jenë shqyrtuar prej tij, por asnjë kundërshtim nuk do të shqyrtohet nga ERE po nuk u mor brenda tri muajsh që nga data e botimit të parë të njoftimit siç përshkruhet në këtë paragraf;

(b) kur merret një kundërshtim nga një autoritet lokal përkatës dhe ERE mendon se kundërshtimi nuk është i mjaftueshëm, ai duhet ta regjistrojë me shkrim dhe t'ia komunikojë atë autoritetit lokal në fjalë duke dhënë arsyet për një mendim të tillë;

(c) një autoritet lokal nuk duhet të bëjë kërkesë për licencë me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe me ligj;

(d) kur ERE nuk vepron në lidhje me këtë kërkesë brenda 90 ditësh, licenca e kërkuar do të gjykohet se është dhënë, duke iu nënshtuar kushteve të licencës së përcaktuara në këtë ligj.

(3) Licenca do të përshkruajë shtrirjen, kushtet dhe afatet gjatë të cilave transmetimi, shpërndarja ose furnizimi i energjisë elektrike është i detyrueshëm ose i lejueshëm dhe duke përfshirë edhe kushte të tjera që ERE i mendon të përshtatshme për të realizuar detyrat e tij sipas këtij ligji.

(4) Kushtet e përfshira në licencë sipas paragrafit (3) mund t'i kërkojnë mbajtësit të licencës:

(a) të hyjë në marrëveshje me persona të tjerë që kanë licencë për shfrytëzimin e linjave elektrike, centraleve elektrike dhe pajisjeve që lidhen me to, (pavarësisht se ku janë vendosur dhe pavarësisht nëse përdoren ose jo me qëllim që mbajtësi i licencës të kryejë veprimtaritë për të cilat është i autorizuar) për qëllime të tilla, të cilat do të përcaktohen në licencë dhe do të përfshijnë dispozitat që do të përcaktojnë kushtet në të cilat duhen lidhur këto marrëveshje;

(b) të zbatojë çdo direktivë që jep Enti i Rregullimit për ato çështje që specifikohen në licencë;

(c) t'i referojë ERE-së për të vendosur mbi çështjet që lindin nga zbatimi i licencës siç specifikohen në licencë;

(d) t'ia referojë ERE-së për miratim ato gjëra që nuk kryhen ose miratohen nga licenca.

(5) Kushtet që përfshihen në licencën e dhënë nga ERE mund të kërkojnë nga mbajtësi i licencës që të përcaktojë një tarifë ose të llogarisë pagesat e tij herë pas here në përputhje me afatet e licencës së tij.

(6) Kushtet që përfshihen në një licencë mund të përmbajnë dispozitën që këto kushte nuk kanë më efekt ose të modifikohen në atë kohë e mënyrë dhe në rrethana të tilla që mund të përcaktohen nga kushtet.

(7) Dhënia e një licence për furnizim sipas këtij neni, mundet që, me vendim të ERE-së, të jetë ekskluzive ose joekskluzive dhe si e tillë duhet përcaktuar në licencë.

(8) Licenca jepet për afat jo më pak se 25 vjet.

Neni 16

Licencat e prodhimit

(1) Te gjitha licencat e prodhimit duhet të jepen me një qëllim të caktuar për të inkurajuar një shfrytëzim të sigurtë, të garantuar dhe ekonomik të Rrjetit të Transmetimit dhe të shoqërive të lidhura me to dhe duhet të shprehë qartë:

- (a) llojin e shërbimit ku zbatohet licenca;

- (b) vendndodhjen e mjeteve të prodhimit ose grupit të mjeteve të prodhimit;
- (c) kohëzgjatjen e licencës që nuk duhet të jetë më pak se jetëgjatësia që pritet e mjeteve të prodhimit dhe t'i nënshtrohet heqjes sipas këtij ligji dhe në përputhje me kushtet dhe afatet e një licence;
- (d) të gjitha kushtet e zbatueshme të licencës.

Neni 17

Kushte të përgjithshme që lidhen me licencat e transmetimit

- (1) Të gjitha licencat e transmetimit duhen dhënë për një afat jo më pak se 25 vjet, me kusht që mund t'i nënshtrohen heqjes sipas këtij ligji dhe në përputhje me afatet dhe kushtet e licencës dhe duhet të shprehin qartë:
- (a) llojin e shërbimit ku zbatohet licenca;
 - (b) territorin ku zbatohet licenca;
 - (c) të gjitha kushtet e zbatueshme të licencës.

Neni 18

Licencat e shpërndarjes (furnizimit)

- (1) Të gjitha licencat e shpërndarjes duhet të jenë me një afat jo më pak se 25 vjet, me kusht që të mund t'i nënshtrohen heqjes sipas këtij ligji dhe në përputhje me afatet dhe kushtet e licencës, si dhe duhet të shprehin qartë:
- (a) llojin e shërbimit ku zbatohet licenca;
 - (b) territorin ku zbatohet licenca;
 - (c) të gjitha kushtet e zbatueshme të licencës.

Neni 19

Detyrat dhe të drejtat e përgjithshme të mbajtësve të licencës

(1) Është detyrë e një mbajtësi licence prodhimi, transmetimi ose shpërndarja në një zonë të caktuar, të zhvillojë dhe të mbajë një sistem eficient, të kordinuar dhe ekonomik të prodhimit, transmetimit ose shpërndarjes së energjisë elektrike, si dhe të lejojë të gjithë prodhuesit e pavarur të lidhen me rrjetin elektrik dhe të detyrojë rrjetin e transmetimit të transmetojë energjinë elektrike të prodhuar brenda kushteve teknike.

(2) Mbajtësi i një licence duhet të zbatojë kushtet dhe afatet e licencës si edhe normat e Rrjetit të Transmetimit ose të Shpërndarjes (sipas rastit) dhe t'i nënshtrohet çdo urdhri ose përjashtimi që mund të japë ERE sipas këtij ligji.

(3) Për mjetet e prodhimit që lidhen drejtpërdrejt ose tërthorazi me Rrjetin e Transmetimit Kombëtar, mbajtësi i një licence prodhimi duhet t'i vërë në dispozicion rrjetit kombëtar të transmetimit mjetin ose mjetet e tij të lejuara të prodhimit për punim të sigurtë, të garantuar, të padiskriminuar dhe ekonomik si edhe për punën e mjeteve të tjera të transmetimit kombëtar dhe t'i nënshtrohet kompensimeve të arsyeshme, që duhet t'i bëhen mbajtësit të licencës së prodhimit për mbështetje tensioni dhe punën joekonomike, që drejtohet nga shoqëria kombëtare e transmetimit.

Neni 20

Heqja e licencave

- (1) ERE ka të drejtë të heqë licencën kur konstaton se mbajtësi i saj:
- (a) nuk plotëson më kushtet e licencës së dhënë sipas këtij ligji;
 - (b) në zbatim të veprimtarisë së licensuar shkel rëndë dispozitat ligjore mbi mbrojtjen e mjedisit;
 - (c) duke shkelur detyrimet e përcaktuara në këtë ligj kërcënon jetën, shëndetin ose pasurinë e njerëzve.
- (2) ERE mund ta heqë licencën në rast se mbajtësi i saj nuk e ka filluar veprimtarinë e licensuar në kohën e përcaktuar në licencë.

(3) ERE ka të drejtë të heqë një licencë që është dhënë sipas këtij ligji kur mbajtësi i licencës nuk arrin të zbatojë kushtet e licencës për arsye financiare.

(4) Kur ERE e sheh se nuk është në interesin publik që ta heqë një licencë të tillë, në vend të heqjes së licencës, vë gjoba ose ndërmerr sanksione të tjera, sipas nenit 13 të këtij ligji, si ta quajë të përshtatshme.

(5) Me rregullore ERE duhet të përcaktojë procedurat e heqjes së licencës, procedura që do të përfshijë njoftimin në kohë të mjaftueshme të mbajtësit të licencës si edhe mundësinë që ai të përgjigjet. ERE duhet:

(a) të njoftojë me shkrim mbajtësin e licencës, kur ERE ka qëllim për t'i hequr licencën, njoftim i cili duhet bërë të paktën gjashtëdhjetë ditë përpara se të hyjë në fuqi heqja dhe të deklarojë qartë arsyet pse e bën këtë;

(b) t'i japë mundësi mbajtësit të licencës që brenda tridhjetë ditëve nga dërgimi i njoftimit, t'i përgjigjet me shkrim njoftimit dhe

(c) t'i japë mbajtësit të licencës tridhjetë ditë, pas përgjigjes me shkrim nga mbajtësi i licencës, që të veprojë në përputhje me licencën, kur ERE e gjykon se kjo është në interesin e përgjithshëm.

(6) Kur ERE e heq një licencë, ai duhet të zbatojë një nga kushtet e përkohshme që jepen më poshtë me qëllim që pajisjet që ka mbajtësi i licencës të vazhdojnë punën:

(a) duke i lejuar mbajtësit të licencës të vazhdojë shfrytëzimin e këtyre pajisjeve sipas kushteve dhe afateve që do të përcaktojë ERE;

(b) duke kontraktuar me një ose disa shoqëri private që të marrin përsipër këtë punë ose

(c) si mjet të fundit, duke caktuar një administrator për të mbikëqyrur ose marrë përsipër shfrytëzimin e pajisjeve në licencë.

Kushtet e përkohshme do të jenë në fuqi derisa t'i jepet licenca personit që do të vazhdojë punën dhe ERE duhet të interesohet që të gjejë një person tjetër me licencë sa më shpejt që të jetë e mundur. Në rastin e heqjes së një licence, ERE duhet t'ia bëjë të detyrueshme shitjen e pajisjeve të mbajtësit të licencës personit pasues me licencë përkundrejt kompensimeve të arsyeshme.

Neni 21

Ndryshime në licencat

(1) Me kërkesë të mbajtësit të licencës dhe kur interesi publik e lejon, ERE mund të bëjë ndryshime në afatet dhe kushtet e licencës që ai i mendon të përshtatshme, pasi të ketë marrë parasysh detyrat e tij në përputhje me nenin 19 më sipër, me kusht që ndryshimet të bëhen me shkrim dhe me konsensusin e mbajtësit të licencës.

(2) Kur mbajtësi i licencës ka bërë një kërkesë sipas paragrafit (1) ku propozon ndryshime ose amendamente në licencën e tij, do të zbatohen këto dispozita:

(a) mbajtësi i licencës do të publikojë një njoftim të kërkesës së tij në mënyrën dhe me hollësitë që kërkon ERE;

(b) ERE nuk duhet të bëjë asnjë ndryshim ose amendament përpara se të ketë marrë të gjitha kundërshtimet në lidhje me këtë kërkesë brenda tre muajsh që nga data e botimit të parë të njoftimit dhe pasi t'i ketë shqyrtuar ato.

(3) Përpara se të bëjë ndonjë ndryshim ose amendament në një licencë, sipas kërkesës së mbajtësit të licencës, ERE duhet të publikojë ndryshimet dhe amendamentet e propozuara dhe të shqyrtojë të gjitha kundërshtimet e marra në lidhje me ndryshimet dhe amendamentet e propozuara brenda tre muajsh nga data e publikimit të parë të njoftimit.

Neni 22

Kufizimet për mbajtësit e licencës dhe shoqëritë e prodhimit

(1) Asnjë mbajtës i licencës, në asnjë kohë, pa pëlqimin paraprak me shkrim të ERE-s nuk do të marrë, duke blerë ose të përfitojë me mënyrë tjetër një licencë, ose të lidhet me një person tjetër me licencë prodhimi, transmetimi, shpërndarjeje. Përpara se të kërkojë miratimin e kërkesës, mbajtësi i licencës duhet të njoftojë me shkrim ERE-në jo më vonë se një muaj për kërkesën e tij.

(2) Mbajtësi i licencës asnjëherë nuk duhet që t'ia japë licencën e tij ose ta transferojë

sipërmarrjen e tij ose ndonjë pjesë të saj nëpërmjet shitjes, hipotekimit, dhënies me qira a këmbimit ose ndryshe, pa pëlqimin paraprak me shkrim të ERE-së.

(3) Përveçse kur shprehimisht ndalohet nga kushtet e licencës, mbajtësi i një licence mund të hyjë në marrëveshje për shitjen ose blerjen e energjisë elektrike me:

(a) mbajtësin e një licence shpërndarjeje që e lejon mbajtësin e saj të furnizojë energji elektrike te persona të tjerë me licencë për ta shpërndarë atë;

(b) çdo person me pëlqimin e ERE-së.

(4) Çdo marrëveshje që lidhet me transaksione të natyrës që përshkruhen në paragrafët (1) ose (2), përveçse kur bëhen me pëlqimin e ERE-së, do të jetë e pavlefshme.

Neni 23

Llogaritë vjetore të mbajtësve të licencës

Përveç rasteve kur licenca përjashtohet nga detyrimi, çdo mbajtës i licencës duhet të përgatisë dhe t'i paraqesë ERE-së çdo vit, në ose përpara datës që specifikohet në licencë, një deklaratë vjetore të llogarive të sipërmarrjes së tij si edhe të çdo biznesi të vecantë, që janë bërë deri në atë datë, në formën dhe me hollësitë që përcaktohen në licencë. Licenca duhet të kërkojë që deklaratatë të tilla të kontrollohen dhe botohen.

PJESA E KATËRT

TARIFAT

Neni 24

Standardet e tarifave

(1) Me anë të rregullave të hartuara brenda një viti që nga data e hyrjes në fuqi e këtij ligji, ERE duhet të përcaktojë procedurat dhe standardet me anë të të cilave ai do të miratojë, modifikojë ose mosmiratojë çmimet e tarifave, afatet dhe kushtet e shërbimit për të gjitha shitjet e energjisë elektrike dhe shërbimet që sigurohen nga personat me licencë sipas këtij ligji, me përjashtim të rasteve kur në këtë ligj parashikohet ndryshe.

(2) Çmimet e tarifave për transmetimin, lidhjen ndërsistemore dhe shpërndarjen (duke përfshirë çmimet e tarifave për shitjet e energjisë elektrike të asociuar) duhet:

(a) të mbrojnë konsumatorët nga çmimet monopol;

(b) të gjykojë për tarifave kryesisht duke i krahasuar me mbajtësit e tjerë të licencave, duke futur elemente të përcaktimit të tarifave nga konkurrenca, oferta e kërkesa;

(c) t'u japin mundësi mbajtësve të licencave që me kostot e tyre kompetitive të sigurojnë shërbim eficient, duke përfshirë mundësinë për të siguruar që fitimet të jenë të mjaftueshme për të tërhequr financime për kapitale dhe për ndërtime të reja ;

(d) të inkurajojnë efektivitetin e operacioneve të brendshme duke bërë të mundur që fitimi i mbajtësit të licencës të rritet duke ulur humbjet joteknike, mospagime të faturave të energjisë elektrike, ose duke ulur koston e shërbimit, me kusht që personi me leje të përmbushë të gjitha kërkesat e licencës së tij në lidhje me sigurimin dhe cilësinë e shërbimit si edhe çdo kërkesë kontraktuale të zbatueshme në lidhje me sigurimin dhe cilësinë e shërbimit;

(e) të inkurajojnë efektivitetin ekonomik brenda sektorit të energjisë elektrike duke dërguar sinjale të sakta për çmimet në lidhje me bollëkun ose mungesën relative të furnizimit;

(f) të lejojnë që mbajtësi i licencës të kompensohet për humbjet financiare si rezultat i ndryshimeve të miratuara paraprakisht nga ERE;

(g) të pasqyrojnë haptazi dhe qartë subvencionet që ka autorizuar Qeveria, duke përfshirë:

(i) subvencione të drejtpërdrejta që jep Qeveria, subvencione që do të financohen kurdoherë që është e mundur me anë të një takse të veçantë për shërbimet elektrike, që duhet të shprehet qartë në faturën e pagesës së energjisë elektrike të konsumatorit dhe

(ii) subvencione të dyfishta me anë të të cilave blerës industrialë, tregtarë, bujqësorë ose përdorues të tjerë të subvencionojnë pjesërisht ose tërësisht, me anë të tarifave ose pagesave për shërbimet elektrike, shërbimin joekonomik ose shërbimin për blerësit e vendit me të ardhura të pakëta,

me kusht që tarifat të konceptohen në mënyrë që të minimizojnë shtrembërime ekonomike;

(h) të pasqyrojnë dallimet në kosto dhe në tregues të tjerë për klasa të ndryshme blerësish si edhe për lloje shërbimesh, me kusht që t'i nënshtrohen subvencioneve të zbatueshme.

(3) Procedurat që do të përcaktojnë ERE sipas paragrafit më sipër duhet të përfshijnë:

(a) afate kohore për zbatimin e tarifave dhe të vendimeve nga ERE;

(b) mundësitë që blerësit dhe palë të tjera të interesuara të marrin pjesë në procesin e miratimit të tarifave;

(c) mbrojtjen e konsumatorëve me anë të rimbursimit në qoftë se tarifat ende nuk janë vendosur.

Neni 25

Procedurat e vendosjes së tarifave

(1) ERE përcakton metodat e procedurat që do të zbatojë mbajtësi i licencës për të llogaritur treguesit ekonomiko-financiarë sipas legjislacionit në fuqi.

(2) Çdo mbajtës i licencës duhet t'i japë ERE-së, të paktën tre muaj përpara se të fillojë viti tjetër financiar, hollësi të plota për llogaritjet e tij për atë vit financiar të të ardhurave dhe shpenzimeve të tij e tregues të tjerë ekonomiko-financiarë, si dhe çdo informacion tjetër shtesë që mund t'i kërkojë ERE .

(3) Brenda 60 ditësh që nga data që mbajtësi i licencës ka dhënë të gjitha informatat që kërkon ERE, ajo duhet ta njoftojë mbajtësin e licencës në rast se ai nuk është dakord me llogaritjet e paraqitura nga mbajtësi i licencës duke dhënë edhe sqarimet e nevojshme.

(4) Asnjë tarifë ose pjesë e ndonjë tarife nuk mund të ndryshohet më tepër se një herë, në një vit financiar, me përjashtim kur është fjala për ndryshime që lejohen nga ERE. Mbajtësi i licencës nuk duhet të ndryshojë ndonjë tarifë pa e miratuar ERE më parë.

(5) Kur mbajtësi i licencës nuk bie dakord me ndryshimin e tarifave e çmimeve të urdhëruara nga ERE, pavarësisht se janë bërë në bazë të këtij ligji por nuk janë shprehur në mënyrë taksative në licencë dhe si rrjedhojë kanë nevojë për interpretime dhe llogaritje, ai ka të drejtë të kërkojë nga ERE që të shpallë kërkesë për transferim licence. ERE menjëherë detyrohet të fillojë procesin e gjetjes së një mbajtësi të ri licence nëpërmjet parazgjedhjes, tenderit e formave të tjera të garës, sipas rregullave standard të ERE-s. Kushti i transferimit të licencës është që mbajtësit të vjetër të licencës t'i kompensohen nga mbajtësi i ri i licencës investimet e paamortizuara si dhe pjesët e shpenzimeve të tjera të kryera nga ai, në bazë të detyrimeve të licencës, të cilat nuk janë shlyer ende si rezultat i ndërprerjes së licencës. Nuk lejohen të konkurrojnë për mbajtës të ri të licencës as persona juridikë shtetërorë shqiptarë, as persona juridikë ku shteti shqiptar zotëron paketë kontrolluese ose mbi 50 për qind të aksioneve, ose aksion të artë. Një mbajtës i ri licence është i gjetur në qoftë se ai pranon tarifa e çmime jo më pak të disfavorshme për të se ato të urdhëruara nga ERE. Në rast se nuk gjendet mbajtës i ri licence atëherë ndryshimet e tarifave dhe çmimeve të urdhëruara konsiderohen të padrejta e anulohen dhe ERE detyrohet që menjëherë t'i paguajë mbajtësit të licencës të gjitha humbjet e shkatuara si nga ndryshimi i tarifave e çmimeve, ashtu dhe nga procesi i gjetjes së një mbajtësi të ri licence. Në rast se gjendet mbajtësi i ri i licencës, atëherë ndryshimet e tarifave dhe çmimeve të urdhëruara konsiderohen të drejta dhe mbajtësi i vjetër i licencës detyrohet t'i paguajë ERE-së të gjitha shpenzimet e bëra për procesin e gjetjes së mbajtësit të ri të licencës. Mbajtësi i vjetër i licencës vazhdon të kryejë detyrimet sipas licencës derisa të kryhet transferimi.

Mbajtësi i vjetër i licencës ka të drejtë të tërhiqet nga pretendimet e tij dhe/ose të pranojë të vazhdojë të mbajë licencën me kushtet e urdhëruara ose të pranuar nga kandidati si mbajtës i ri i licencës me kusht që përveç detyrimeve të shprehura në paragrafët më sipër t'i kompensojë këtij të fundit të gjitha shpenzimet e humbjet e shkaktuara nga pjesëmarrja në procesin e gjetjes së mbajtësit të ri të licencës.

Neni 26

Kërkesat për të nxjerrë një urdhër

(1) Kur ERE është i bindur se mbajtësi i licencës po shkel ose ka të ngjarë të shkelë ndonjërin prej kushteve ose kërkesave të licencës së tij, ose të këtij ligji, ai duhet të nxjerrë një urdhër ku të japë ato direktiva që ai i quan të nevojshme për të siguruar zbatimin e tij.

(2) Për të përcaktuar nëse është me vend të nxirret një urdhër, ERE duhet të ketë veçanërisht parasysh:

(a) masën në të cilën një person mund ta përballojë një humbje ose dëmtim që rrjedh nga veprimet ose mosveprimet, që janë në kundërshtim me kushtet ose kërkesat e licencës;

(b) masën për riparime të mundshme (duke patur parasysh dispozitat e mëposhtme të këtij neni) në lidhje me kundërshtimin e shfaqur ose kushtet apo kërkesat përkatëse.

(3) Kur ERE gjykon të nxjerrë një urdhër, ai duhet të njoftojë mbajtësin e licencës:

(a) duke deklaruar se ai gjykon të nxjerrë një urdhër;

(b) duke vënë në dukje kushtet ose kërkesat përkatëse për të cilat urdhri kërkon të zbatohet, veprimet ose mosveprimet që sipas mendimit të tij përbëjnë shkelje të kushteve ose kërkesave, gjithashtu dhe fakte të tjera që sipas mendimit të tij e justifikojnë nxjerrjen dhe pasojat e këtij urdhri;

(c) duke specifikuar periudhën (që duhet të jetë jo më pak se pesë ditë nga data e njoftimit) brenda së cilës mbajtësi i licencës mund të bëjë shpjegime ose kundërshtime të urdhrin të propozuar.

(4) Duke iu nënshtuar paragrafit (5) më poshtë, pasi të ketë marrë parasysh të gjitha shpjegimet ose kundërshtimet e mbajtësit të licencës në përputhje me paragrafin (3,c) më sipër, ERE mund të nxjerrë një urdhër (i cili mund të modifikohet nga ai i propozuar pas shpjegimeve dhe kundërshtimeve të mbajtësit të licencës) në çdo kohë pas skadimit të periudhës së përcaktuar në paragrafin (3,c), në qoftë se:

(a) ERE ka arsye të mjaftueshme për të besuar se mbajtësi i licencës me të cilin ka të bëjë urdhri po shkel ose ka të ngjarë të shkelë ndonjërin prej kushteve apo kërkesave përkatëse ose

(b) urdhri i nxjerrë ka për qëllim sigurimin e përputhjes me kushtet dhe kërkesat.

(5) ERE nuk duhet të nxjerrë një urdhër kur:

(a) mbajtësi i licencës ka rënë dakord të marrë dhe po merr të gjitha masat, që ERE gjykon që ai duhej të ndërmarrë për të siguruar ose për të lehtësuar zbatimin e kushteve ose kërkesave në fjalë, ose

(b) kur shkeljet kanë qenë ose kanë pasur të ngjarë të ishin të një natyre të parëndësishme.

(6) Një urdhër duhet të kërkojë që mbajtësi i licencës me të cilin urdhri ka të bëjë (sipas rrethanave të rastit) me kryerjen ose moskryerjen e kërkesave që përcaktohen në urdhër.

(7) Sa më shpejt që të jetë e mundur ERE duhet:

(a) t'i dërgojë një kopje të urdhrin mbajtësit të licencës me të cilin ka të bëjë urdhri;

(b) ta publikojë urdhrin në mënyrën që ai e quan të përshtatshme me qëllim që të tërheqë vëmendjen e personave që kanë të ngjarë të preken prej tij;

(c) të nisë zbatimin e procedurave sipas urdhrin në fjalë.

Neni 27

Vlefshmëria dhe efekti i urdhrave

(1) Kur mbajtësi i licencës me të cilin ka të bëjë urdhri është i pakënaqur me të dhe ka dëshirë të verë në diskutim vlefshmërinë e tij për shkak se

(a) nxjerrja e urdhrin nuk është e drejtë e ERE-s sipas nenit 26 ose se kërkesat e nenit 26 nuk janë zbatuar në lidhje me të, ose

(b) ERE nuk ka dhënë arsye për atë vendim, mbajtësi i licencës ka të drejtë që brenda gjashtëdhjetë ditësh që ka marrë urdhrin, t'i bëjë kërkesë gjykatës kompetente sipas këtij neni.

(2) Pas marrjes së një kërkesë të tillë gjykata në rast se është e bindur se nxjerrja e urdhrin nuk ka qenë e drejtë e ERE-së, ose se interesat e mbajtësit të licencës janë paragjykuar rëndë nga mospërbushja e këtyre kërkesave, mund të anulojë urdhrin ose ndonjë dispozitë të tij.

(3) Vlefshmëria e një urdhri nuk duhet të vihet në diskutim nga asnjë procedurë ligjore, për asnjë arsye tjetër, përveç atyre që parashikohen në paragrafin (1), me kusht që në rast se një urdhër i ERE-s vihet në diskutim, ERE duhet ta rishikojë vendimin e tij në përputhje me paragrafin (5) të këtij

neni.

(4) Detyrimi për të zbatuar një urdhër është detyrë e çdo personi që mund të preket nga ai urdhër.

(5) Kur sipas paragrafit (4) një person ka detyrime ndaj një personi tjetër, për çdo shkelje të detyrimit, që i shkakton atij personi dëm ose humbje, ai person mund të ndërmarrë veprime kundër tij.

(6) Pa patur paragjykim për ndonjë të drejtë, që mund të ketë një person në bazë të paragrafit (5) për të ndërmarrë procedura civile, bindja ndaj urdhrimit është një e drejtë që ERE e kërkon për zbatim.

Neni 28

Sanksione të tjera

(1) ERE ka të drejtë të vërë gjoba për shkelje ditore, për çdo ditë që ndodh shkelja, të ndërmarrë veprime të tjera të arsyeshme dhe të vendosë sanksione të tjera, që ai i quan të arsyeshme me qëllim që të bëjë të mundur zbatimin e këtij ligji, me kusht që kufiri i gjobave sipas urdhrimit të ERE-s të ndjekë inflacionin.

(2) Brenda një viti që nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, ERE duhet të hartojë aktin ligjor që përcakton ushtrimin e të drejtave të tij sipas paragrafit (1) më sipër, duke ia paraqitur për miratim organit kompetent.

(3) Përpara se të zbatohet rregullat sipas paragrafit (2) me sipër, ERE duhet:

(a) të njoftojë me shkrim për qëllimin e tij për të vendosur një sanksion njoftim që duhet të jepet të paktën pesëmbëdhjetë ditë përpara vendosjes së sanksionit, dhe të deklarojë qartë arsyet për sanksionin;

(b) t'i japë mundësi palës së interesuar të tregojë arsyet, me gojë ose me shkrim, si ta quajë të arsyeshme ERE, se pse nuk duhet vendosur ky sanksion me kusht që asnjë nga kërkesat e paragrafit (3) të mos zbatohen në rrethana të jashtëzakonshme, që mund t'i kërkojë interesi publik.

Neni 29

Çështje tranzitore

Pavarësisht nga ndonjë dispozitë tjetër e këtij ligji, ERE nuk duhet të nxjerrë një urdhër ose të hartojë ndonjë rregull që të pakësojë ose të zgjerojë, pa pëlqimin reciprok të palëve, të drejtat ose detyrimet që paraqiten në një kontratë në fuqi që nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, duke përfshirë të drejtën e çdo personi për të përfutur interesat dhe tarifën, që i takojnë sipas një kontrate të tillë.

Neni 30

Programet e investimeve

(1) Me anë të rregullores së hartuar brenda tetëmbëdhjetë muajsh që nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, ERE duhet të përcaktojë procedurat dhe standardet për miratimin paraprak të programeve të investimeve të mbajtësve të licences sic paraqiten në këtë ligj, procedura dhe standarde që të sigurojnë që programi i investimeve të bëhet i efektshëm nëntëdhjetë ditë pas parashtrimit përpara ERE-s, me përjashtim të rasteve kur ERE, brenda nëntëdhjetë ditësh që nga parashtrimi, nxjerr një urdhër me anë të të cilit nuk e miraton, ose e modifikon programin.

(2) Çdo procedurë dhe standard që vendos ERE sipas këtij neni duhet të inkurajojë synimin për pakësimin e mbikëqyrjes rregulluese të kontratave që ka bërë mbajtësi i licencës.

(3) Çdo program investimesh që miraton ERE sipas këtij neni duhet të marrë parasysh planet kombëtare të energjisë elektrike që ka nxjerrë Qeveria.

(4) Me miratimin nga ERE të programit të investimeve, ERE duhet ta lejojë mbajtësin e një licence shpërndarjeje që të hyjë në kontrata afatgjata për blerjen e energjisë elektrike pa miratimin paraprak apo rishikim të mëvonshëm (duke mos përfshirë çmimet dhe tarifën e shoqërisë ndaj konsumatorëve, që mbajtësi i licencës shpërndarjeje merr sipas kontratës), kur këto kontrata janë lidhur në përputhje me procedurat dhe standardet e programit të miratuar të investimeve.

(5) Kur mbajtësi i një licencë shpërndarjeje hyn në një kontratë afatgjatë për blerjen e energjisë elektrike përpara hartimit të rregullores sipas këtij neni, ose zhvillimit të programit të

investimeve të përkohshëm, kontrata, blerjet që mundëson ajo, çmimet dhe tarifatat që parashikon nuk do t'i nënshtrohen miratimit paraprak ose rishikimit të mëvonshëm, me kusht që kontrata të vlerësohet se është rezultat i bisedimeve korrekte.

Neni 31 **Standardet e punës**

(1) Me rregullore të hartuar tetëmbëdhjetë muaj pas datës së hyrjes në fuqi të këtij ligji, ERE duhet të përcaktojë standardet e punës për shoqëritë e prodhimit, të transmetimit dhe të shpërndarjes. Këto standarde duhet të inkurajojnë shërbimin e sigurtë, të garantuar dhe të qëndrueshëm dhe duhet të përfshijnë midis të tjerash ato standarde, që ERE i quan të arsyeshme, në lidhje me:

- (a) treguesit karakteristikë të shërbimit, si tensioni dhe qëndrueshmëria;
- (b) ndërprerjet e parashikuara dhe të paparashikuara;
- (c) kufijtë e rezervës;
- (d) kohën që kërkohet për të lidhur konsumatorë të rinj, me kusht që shoqëritë e shpërndarjes në çdo rast (duke përfshirë edhe kohën përpara hartimit të rregullores nga ERE) duhet të vendosin lidhje të reja brenda katërmëdhjetë ditësh nga marrja e kërkesës për shërbim, përveçse kur ERE, me rregullore, justifikon një afat përfundimtar prej më pak ose më shumë se katërmëdhjetë ditë në rrethana të përcaktuara;
- (e) numrin dhe kohëzgjatjen e periudhave të ndërprerjes së energjisë elektrike;
- (f) sigurinë.

Neni 32 **Standardet dhe normat e shfrytëzimit**

(1) ERE duhet të inkurajojë, me çdo lloj mënyrë që ai e quan të arsyeshme, zhvillimin e standardeve dhe normat e punës të sektorit të energjisë elektrike, që duhet të zbatohen njëjloj në Republikën e Shqipërisë. Këto standarde dhe kode do të përfshijnë:

- (a) kriteret e planifikimit për sigurinë, qëndrueshmërinë dhe ekonominë e sektorit të energjisë elektrike;
- (b) praktikën dhe standardet e ndërtimit;
- (c) standardet dhe procedurat e punës;
- (d) afatet e mirëmbajtjes;
- (e) mbajtjen e rezervave të përshtatshme në rrotullim dhe plane për të plotësuar kërkesat;
- (f) karakteristikat teknike dhe standardizimin e pajisjeve;
- (g) procedurat e punës dhe të restaurimit.

PJESA E GJASHTË ADMINISTRIMI DHE PROCEDURAT

Neni 33 **Rregulloret**

(1) Rregulloret e hartuara nga ERE duhet të botohen dhe duhet të kenë efektin e ligjit. Rregullat e ERE-s mund të ndryshohen herë pas here, kur ai e quan të arsyeshme.

(2) Duke filluar një vit pas krijimit të tij, ERE duhet që çdo vit të paraqesë një raport me shkrim në Qeveri ku të përshkruajë me hollësi ecurinë e punës së tij në përfundimin e rregulloreve dhe në kryerjen e detyrave të tjera të tij sipas këtij ligji.

Neni 34 **Hetimet**

ERE duhet të hetojë çdo fakt, kusht, praktikë ose çështje që ai i quan të nevojshme ose të përshtatshme për të përcaktuar nëse një person ka shkelur ose ka ndër mend të shkelë ndonjëherë prej dispozitave të këtij ligji, ndonjë rregull, ose urdhër që rrjedh prej tyre, apo për të ndihmuar në zbatimin

e dispozitave të këtij ligji, ose në përshkrimin e rregullave që rrjedhin prej tij.

Neni 35

Aktet nënligjore

Të gjitha urdhrat, vendimet dhe rregulloret e ERE-së:

- (1) duhen nxjerrë me shkrim;
- (2) duhen të përcaktojnë:
 - (a) anëtarët e këshillit drejtues të ERE-së (duke përfshirë Kryetarin) që ka votuar për këtë urdhër, vendim ose rregullore dhe
 - (b) votën e secilit anëtar;
- (3) duhet të përfshijë një shpjegim më shkrim të arsyeve të tyre.

Neni 36

Ankesat

Çdo person i interesuar mund të dorëzojë një ankesë me shkrim në ERE kundër një mbajtësi i licencës, kur pretendon se ka shkelje të ndonjëres prej dispozitave të këtij ligji, ose të një urdhri, rregulloreje ose udhëzimi të hartuar ose të nxjerrë në përputhje me to. ERE duhet t'i japë menjëherë mbajtësit të licencës njoftim me shkrim për ankesën dhe t'i krijojë një mundësi që ai të përgjigjet me shkrim.

Neni 37

Mbledhja e raporteve dhe informacionit

(1) ERE duhet t'i paraqesë Kuvendit Popullor dhe Qeverisë pas përfundimit të çdo viti financiar një raport vjetor të gjendjes ekonomiko-financiare, për gjendjen e energjisë elektrike e të punëve për atë vit, duke vënë në dukje zhvillimet që priten për vitin tjetër.

(2) Sipas rregullores se hartuar nga ERE, çdo mbajtës i licencës sipas këtij ligji duhet t'i paraqesë ERE-së çdo raport, deklaratë dhe informacion që ERE, me rregullore, e kërkon si absolutisht të nevojshme për sigurinë, lidhur me drejtimin ekonomik dhe për shfrytëzimin operativ të Rrjetit të Transmetimit si edhe të mjeteve të lidhura dhe për kryerjen efektive të detyrave të ERE-së sipas këtij ligji.

Neni 38

Dosjet publike

ERE duhet të mbajë dosje publike të cilat duhen mbajtur të hapura në formë të përshtatshme që publiku të mund t'i inspektojë dhe shqyrtojë gjatë orëve të arsyeshme të punës. Dosjet publike të ERE-së duhet të përfshijnë të gjitha dokumentet përkatëse që duhen mbajtur dhe indeksuar nga ERE, me kusht që t'i nënshtrohen procedurave dhe standardeve për trajtimin konfidencial që i vendos ERE.

Neni 39

Çdo dispozitë që bie në kundërshtim me këtë ligj shfuqizohet.

Neni 40

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.7970, datë 11.8.1995 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha

